



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 13 REP
NR. 8 KOL

**AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“PESCADO” SHPK**

Ne Tirane, sot me date 04.01. 2017, përparrë meje nôteres Mimoza I. Sadushaj, me zyre ne Rr “Vaso Pasha” pallati 13, ap 1, u pâraqitën personalisht ortaket themelues si më poshtë:

1. **Z. Endri Bylyku**, shtetas Shqiptar, i biri i Iglit, lindur me 21.06.1989 ne Tirane, mbajtes i pasaportes me nr.BA9587455, madhor e me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.
2. **Znj. Mirela Zeraliu**, shtetase Shqiptare, e bija e Eduartit, lindur me 21.11.1963 ne Tirane, mbajtese e kartes se identitetit me nr.G36121047G, madhore e me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar.

Te cilet hartojojne kete Akt -Themelimi te shoqerise “**PESCADO**” SHPK, mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimot, si me poshte:

KREU 1

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “**PESCADO**” SHPK, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR), ne përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi te ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj te tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë se saj.

Shoqeria “**PESCADO**” shpk, eshte nje shoqeri, qe themelohet ndërmjet ortakeve qe përballojnë humbje vetem deri ne kufirin e vlerës se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar



Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane ne adresen Rruga e Kavajes/ish Parku i Mallrave,Kompleksi Delijorgji objekti C1C2,ambiente sherbimi ne hyrjen B AXI 13,15: E,D dhe Hyrjen B AXI 14,15 dhe C,D,kati perdhe.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij,te hape zyra perfaqesie,dege,te krijoje filiale,si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise,vetem me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte:aktivitet ne fushen e sherbimit dhe kulinarise dhe me konkretisht,Bar dhe Restorant me baze prodhime deti e te tjera,si dhe furnizimin me produkte ushqimore dhe pije si pjese e aktivitet tregtar.

Shoqeria mund te kryeje cdo lloj aktiviteti tregtar qe shoqeria do te jete ne gjendje ta ushtroje.Shoqeria mund te kryeje cfareolloj sherbimi qe paraqitet ne pajtueshmeri me objektin e saj dhe qe eshte e lidhur me kete objekt,duke perjashtuar ato sherbime apo veprimtari qe do te shkaktonin devijimin e saj nga karakteri plotesisht i percaktuar me ligje te vecanta.

Shoqeria mund te bashkohet dhe te marre pjese edhe vullnetarisht ne konsorciume per prodhimin dhe tregtine,si dhe te marre pjese ne sipermarjet e perbashketa per iniciativa te caktuara te biznesit ose industrise; te marre pjese ne shoqata,konsorciume dhe organizata qe kane tendence per te lehtesuar dhenien e kredive me kushte te favorishme,ose granteve.

Mund te marre kredi dhe / ose hua nga ortaket si dhe nga shoqerite e grupit (shoqerite meme, filialat dhe bashkepunetoret),qofte me kamate ose interes zero ose me norme detyruese per rikthim ne natyre.

Shoqeria mund te kryeje transaksione financiare,dhe te pasurive te paluajtshme qe do te konsiderohen te nevojshme ose te dobishme per arritjen e qellimis te shoqerise,te marre pjese ne shoqeri te tjera me objekt te njejtë,te ngjashejm apo qe lidhet me aktivitetin e vet kryesor,si dhe te jape garanci per hua si dhe garanci hipotekore ne favor te ortakeve dhe ne favor te te treteve.

Neni 5
Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise "PESCADO" SHPK eshte e pakufizuar,

KREU II KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000 lekë (dhjete mijë leke) e barabarte me 2 kuota.

a)Ortaku **Endri Bylyku**,eshte zoterues ne masen 50 % e barabarte kjo me 1 kuote.

b)Ortaku **Mirela Zeraliu**,eshte zoterues ne masen 50% e barabarte kjo me 1 kuote.

Kontributi(kapitali aksionar) i ortakeve eshte ne para(leke).

Ortaket e ardhshem kane derdhur shumen korresponduese te pjeseve te nenshkuara.

Ortaket qe firmosin kete akt pasi ka marre dijeni per kete certefikate,nje kopie ekzakte e se ciles i eshte paraqitur atij deklaron se shuma e mesiperme eshte ne perputhje me ate qe shenohet ne certefikate dhe se ato konfirmojne nenshkrimet e pjeseve te kapitalit themeltar ne perputhje me shumen respektive te derdhur.


Ortaku,që pengohet të ushtrojë të drejtat që i trjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë,ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar,si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që trjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- 1.a)kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b)shitblerjes;
- c)trashëgimisë;
- d)dhurimit;
- d)çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligji.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë,kontrata duhet të bëhet me shkrim.
4. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave,veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
5. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë,kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën,si dhe kushtet e tjera të kalimit,përfshirë momentin e pagesës së çmimit,rregullohen nga kontrata.Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.Me përashtim të rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë,vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formalitetave të ndryshme me efekt deklarativ,përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.





KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te peraktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e çendimeve për shoqerinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion finansiar kreditor;
- j) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga **Mirela Zeraliu**, sipas statutit dhe ligjit per një periudhe 3 vjecare me te drejte riperteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çlonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person jashtë ortakerise.



Neni 10
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqérinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- c) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrrethanat, që kercenojnë mbarëvajten e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportoje përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqérinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat përfshirë të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si perpara Bankave te të gjitha niveleve, per te kryer derdhje, terheqje, transfefta, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoritetet e Doganore, etj, në të gjitha rrrethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqérinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqerise, nje Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.


Neni 12
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe statutin e shoqerise dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin-e ketij akti themelimi, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te tretëve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtarë

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permabatje dhe vlera te njejtave juridike, ne gjuhjen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "PESCA DO" shpk, nenshkruehet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orginale, ne prani te noteres M. Sadushaj.
Une noterja, M. Sadushaj, pasi u sigurova per identitetin e tyre, konstatova se ata e gjejne ate te rregullt ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe Une i vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit.

ORTAKET THEMELUES
TE SHOQERISE "PESCA DO" SHPK

ENDRI BYLYKU



MIRELA ZERALIU

